

AKT THEMELIMI DHE STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"UNIQUE MEDIATION · REPRESENTATION"

Redon Bajraktari i Biri i Shpetimit dhe i Viollces i dtl.26/10/1984, lindur dhe banues ne:Tirane Rruga Nikolla Lena Nr.98. me shtesi Shqiptare, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,me nr personal I41026044U.

Iva Bajraktari (Hazbiu) e Bija e Kujtimit dhe e Elides e dtl.15/02/1991, lindur ne Elbasan dhe banues ne:Tirane Rruga Nikolla Lena Nr.98. me shtesi Shqiptare, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar,me nr personal J15215091L.

Ne cilesine e ortakeve kemi redaktuar kete akt themelimi dhe statut, per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "**Unique Mediation Representation**" SHPK. ne respektim te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008,"Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, Ligjit nr 131/2015 Per Qendren Kombetare te Biznesit dhe Ligjit Nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar.

Neni 1
Emertimi i Shoqerise

Shoqeria e emertuar "**Unique Mediation Representation**" (me poshte e quajtur "Shoqeria"), eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, themeluar ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.

Shoqeria eshte themeluar sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptare prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Neni 2
Selia

Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen:Rruga, Migjeni,Pasuria nr.369/9 N9/10 Yzberish,Tirane Shoqeria mund te hape zyra perfaqesimi, degje dhe/ose filiale dhe/ose te marre pjese ne shoqeri te tjera, te kryeje aktivitet ne vende te tjera, qofte brenda apo jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me vendimet e Asamblesese Pergjithshme te Ortakeve.

Neni 3
Kohczgjalja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit.



Neni 4 Objekti

Objekti kryesor i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

Studio ligjore, konsulenca juridike, sherbime ne funksion te ushtrimit te profesionit te Avokatise, dhe Ndermjetesimit, Ekspertize, Konsulence, Ndermjetesim, Perfaqesim dhe Shitblerje e pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme, Blerje dhe mbledhje e debive (borxheve) nga institucione ekonomike private apo individe, Trajtime dhe kurse profesionale ne fushen Ndermjetesuese dhe Ligjore.

Neni 5 Kapitali

Kapitali i Shoqerise eshte 100 (njqind) Leke, i ndare ne 2 kuota, vlora e te cilave zoterohet nga Ortaket si me poshte:

Redon Bajraktari, mbajtes i 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 50% te kapitalit me vleren 50 (pescdhjete) leke;

Iva Bajraktari, mbajtes i 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 50% te kapitalit me vleren 50 (pescdhjete) leke;

Kuotat jane te transferueshme dhe mund te transferohen ne cdo kohe ne perputhje me kushtet dhe afatet qe pcreaktohen ne ligjin Shqiptar.

Pergjegjësia e Ortakut shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

Neni 6 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Ne baze te ligjeve dhe dispozitave te ketij Statuti, asambleja e pergjithshme e ortakeve te Shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i Shoqerise. Ajo perfaqeson te gjithë ortaket dhe vendimet e saj, te marra ne perputhje me ligjin dhe kete Statut, jane detyruese per ortaket.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve te meposhteme:

Percaktimi i politikave tregtare te Shoqerise:

1. Miratimi i ndryshimeve te statutit;
2. Emerimi e shkarkimi i anetareve te Keshillit Administrativ/Administratorit te Vetem si dhe percaktimi i kompetencave dhe shperblimit te tyre;
3. Emerimi e shkarkimi i likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar si dhe percaktimi i shperblimit te tyre;
4. Mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga Keshilli Administrativ/Administratori i vetem, perfshire mbikeqyrjen e pergatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
5. Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
6. Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
7. Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;



8. Caktimin e përfaqësuesit të Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj anëtarëve të Këshillit Administrativ/Administratorit të vetëm;
9. Miratimin e riorganizimit të Shoqërisë, përfshirë bashkimin me shoqëri të tjera, ndarjen e Shoqërisë, shndërrimin e Shoqërisë si dhe prishjen e Shoqërisë;
10. Miratimin e rregullave të mbledhjeve të asamblese së ortakëve.
11. Cështje të tjera të parashikuara nga Ligji apo statuti.

Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblese duke patur të drejtën e votes në raport me vlerën nominale të kuotes së tij. Cdo ortak mund të përfaqësohet në vendimarrje nga një ortak tjetër, nga bashkëshorti(ja) ose nga gdo person tjetër, me kushtin që përfaqësuesit të jenë të pajisur me autorizimin për atë qëllim.

Cdo ortak mund të jetë administrator pranë shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit brenda 6 muajve nga përfundimi i vitit ushtrimor me kërkesën me shkrim të njerit nga ortakët me vlerë nominale të kuotes së tij mbi 30%. Kërkesa duhet të dërgohet me postë tek ortakët e tjerë të paktën 7 ditë kalendarike përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblese.

Përveç se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos në mënyrë të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë me shumë së 75% (shtatëdhjetepesë përqind) të numrit total të votave dhe vendimet merren me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Për të vendosur shpërndarjen e fitimit, ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar si dhe riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm ose të përfaqësuar ortakët që zoterojnë me shumë së 75% (shtatëdhjetepesë përqind) të numrit total të votave. Vendimi merret me votë pro të të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë) përqind të ortakëve të pranishëm.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të vendosë për shkak të mungesës së kuorumit të përcaktuar më lart, ajo mbledhet perseri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë,

Neni 7 **Administrimi i Shoqërisë**

1. Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Adminsirstori/ Adminsirstoret.
2. Administratori/ Adminsirstoret emërohet me vendim të Ortakëve dhe qëndron në këtë detyrë për një afat jo më të gjatë se 5 vjet. Administratori/ Adminsirstoret mund të rizgjidhet për të njëjten periudhë me vendim të Ortakëve të shoqërisë.
3. Administratori/ Administratorët mund të shkarkohen me vendim të ortakëve në çdo moment për arsye të justifikuara.
4. Administratori është personalisht përgjegjës përpara Shoqërisë dhe/ose paleve të treta për dëme të shkaktuara nga shkelja e dispozitave të këtij Statuti ose të Ligjit.



Vendimi i parc i ortakeve do te jete pjese integrale e ketij Statuti dhe Akt themelimi si me poshte:

Administratore e Shoqerise do te jete:

Iva Bajraktari (Hazbiu) e Bija e Kujtimit dhe e Elides e dtl.15/02/1991, lindur ne Elbasan dhe banues ne: Tirane Rruga Nikolla Lena Nr.98. me shtesi Shqiptare, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me nr personal J15215091L.

Neni 8

Detyrat dhe Kompetencat e Administratorit

Pasuria dhe aktiviteti tregtar i Shoqerise do te administrohen nga Administratori, i cili ka te drejte te ushtroje te gjitha kompetencat qe gjykon te nevojshme per realizimin e objektit te Shoqerise, me perjashtim te atyre qe ky statut dhe ligji i ka rezervuar Ortakeve te Shoqerise.

Administratori mund te autorizoj apo emeroje me ane te prokures personave te trete per te kryer veprimtarine ose kopetencave qe i perkasin administratoreve.

Kopetencat e Administratoreve ne lidhje me administrimin dhe mbikqyrjen e veprimtarise se shoqerise percaktohen por pa u kufizuar si meposhte vijon:

1. Te zbatoje politikat tregtare te Shoqerise dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
2. Te siguroje qe Shoqeria respekton ligjin(ct) e zbalueshem dhe standardet kontabel.
3. Te kryeje te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e veprimtarise tregtare.
4. Te perfaqesoj Shoqerine kundrejt paleve te treta, entiteve publike apo private, si dhe entiteve ose autoriteteve vendase ose te huaja;
5. Te pergatite dhe nenshkruaje pasqyrat financiare vjetore te Shoqerise te cilat do te miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.
6. Te kryeje te gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqerine sipas parashikimeve te ligjit te ne fuqi;
7. Te punesoj dhe te shkarkoj punonjes sipas politikave te shoqerise;
8. Te hartoj dhe te nenshkruaje deklaratat tatimore dhe cdo akt tjeter qe ka lidhje me dokumentacionin qe duhet te dorzohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ose autoriteteve te tjera.
9. te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne Statut.

Neni 9

Ekspert(et) Kontabel te Regjistruar

1. Eksperti(ct) kontabel te regjistruar do te emerohet(n) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rastet kur kjo eshte kerkese e legjislacionit shqiptar.
2. Ricmerimi i ekspertit(ve) kontabel te regjistruar do te behet ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.
3. Eksperti(et) kontabel i regjistruar mund te shkarkohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rast te shkeljeve te detyrave, gabimeve dhe sjelljes jo te mire profesionale.



Neni 10
Viti Ushtrimor

Viti Ushtrimor fillon ne 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te gdo viti. Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon me daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe perfundon me date 31 Dhjetor 2022.

Neni 11
Shperndarja dhe Prishja

Shoqeria mund te shperndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Shperndarja e shoqerise do te ndiqet nga prishja e saj. Shoqeria do te ruaje personalitetin juridik, i cili do te sherbeje per qellimet e likuidimit dhe emrin e shoqerise do ta pasojne fjalet **"ne prove likuidimi"**. Likudatori(et) do te emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Prishja e Shoqerise dhe emerimi i likuidatoreve kryhet ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

Neni 12
Ligji i Zbatueshem

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin Shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit shqiptar per shoqerite tregtare.

Neni 13
Mosmarveshjet

Per cdo mosmarveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij statuti dhe per gdo mosmarveshje qe mund te linde ndermjet Shoqerise dhe paleve te treta, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jene gjykatat shqiptare.

Neni 14
Ndryshimet


Ky statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri me vendim te Asamblese se Ortakeve. Ky statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"Unique Mediation Representation"** hartohet ne 3 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte secila.

ORTAKET E SHOQERISE

Redon Bajraktari



Iva Bajraktari (Hazbiu)



TIRANE 12.06.2022